

STATUSI

QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.)

Tiranë, sot me datën ___/05.2025, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë si Bordi Drejtues I "QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.) me pjesëtarë:

1. Z.Grej MALO, I datëlindjes 22.10.1986, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, në adresën, I identifikuar me kartë identiteti nr I61022040Q
2. Z.Nebi MUCAJ, I datëlindjes 21.09.1967, lindur në Prishte dhe banues në Tiranë, I identifikuar me kartë identiteti nr G70921029B
3. Z.Julian BENDO, I datëlindjes 01.11.1993, lindur në Tepelene dhe banues në Tiranë, I identifikuar me kartë identiteti nr J31101075T
4. Znj.Miranda PRIFTI, e datëlindjes 01.08.1985, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, I identifikuar me kartë identiteti nr I55801085K
5. Z.Gentian HOXHALLI, I datëlindjes 04.07.1986, lindur në Shkoder, dhe banues në Tiranë, I identifikuar me kartë identiteti nr I60704092T

Deklaron me vullnetin e tyre të lirë e të plotë në mbështetje të themeluesit, z. Nebi MUCAJ të Q.V.E.C., në mbështetje të legjislacionit shqiptar, si më poshtë vijon:

NENI 1 STATUSI LIGJOR

Q.V.E.C. , do të ketë statusin e personit juridik sipas ligjit dhe të drejtës shqiptare, do të ketë pavarësinë e saj ekonomike dhe administrative dhe do të funksionojë si organizatë jofitimprurëse dhe jo qeveritare në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Kjo organizatë (OJQ) do të ushtrojë veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me institucionet shqiptare dhe nderkombetare, autoritetet qendrore e locale, pa dallime.

NENI 2 VENDNDODHJA

Vendndodhja e Q.V.E.C. , do të përcaktohet nga drejtuesi i saj, e cila do të realizohet me kontratë qeramarrje ose sipas një marrëveshjeje tjetër të përligjur.

Q.V.E.C., do të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të zgjerohet e të hapë degët e tjera. Me kërkesë dhe me miratim të Bordit Drejtues ushtron aktivitetin dhe jashtë territorin shqiptar. Q.V.E.C. mund të bashkëpunojë me organizata të tjera brënda dhe jashtë vëndit, të cilat

kanë synim mbështetjen, koordinimin dhe bashkëpunimin e tyre në interes të realizimit të qëllimeve të përcaktuara më parë.

NENI 3 QELLIMI I Q.V.E.C.

1. Ka për qëllim të ofrojë ndihme humanitare në rastet e emergjencave civile, katastrofave ose fatkeqësive në masë, të ofrojë shërbimin e saj humanitar ndaj institucioneve të ndryshme të ligjshme brenda dhe jashtë shtetit, do të jetë strukturë e pavarur vepruese, studimore, edukative, humanitare.

2. Q.V.E.C. themelohet me qëllimin e mëposhtëm:

- a) Të hartojë programe që synojnë parapërgatitjen për parandalimin, zbutjen dhe veprimet në raste të situatave të ndryshme emergjente.
- b) Të bashkëpunojë me institucione qeveritarë dhe jo qeveritarë, për realizimin e studimeve, ekspertizave, trajnimeve për veprime të menjëherëshme dhe menaxhimin e situatave të krijuara.
- c) Të veproj dhe të bashkëpunoj në mbështetje të autoriteteve qendrore dhe lokale, në raste të fatkeqësive, emergjencave civile, katastrofave në masë dhe emergjencave të ndryshme që mund të paraqiten. Në kohë dhe rastesh emergjencash por dhe në kohë qetesie dhe normaliteti.
- d) Të marrë pjesë dhe/ose të inicioj projekte dhe shërbime të ndryshme të tenderueshme në shërbim të komunitetit me qëllim ofrimin e një perkujdesje dhe cilesie shërbimi me të mirë; dhe të ardhurat e perfituara të shërbej organizatës me qëllim rritjen e kapaciteteve të saj dhe forcimin e cilesisë së shërbimit ndaj komunitetit.
- e) Të bëjë trajnime për personelin, për kontribuesit vullnetar të organizatës dhe për individ ose profesionist të lirë që kërkojnë të trajnohen/arsimohen nga kjo organizatë. Për këtë qëllim, mund të aplikojmë në të ardhmen edhe për krijimin e një institucioni arsimor mbi edukimin e emergjencave civile, urgjencave mjekësore paraspitalore, shpëtimi dhe mbrojtja nga zjarri, etj.
- f) Të kontribuojë aktivisht për çështjet e natyrës dhe ekosistemit me qëllim përmirësimin e kushteve dhe politikave ambientaliste.
- g) Të kontribuojë aktivisht për çështjet social-kulturore dhe humanitare për të mirën e shoqërisë në tërësi, me fokus rininë dhe moshën e tretë.
- h) Të bashkëpunoj me institucione sportive për të kontribuar në të mirën e sportit Shqiptar në tërësi.

NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti I veprimtarisë do të jetë në këto fusha:

1. Te jete force operationale: zjarrfikese, kerkim shpetimi, ndihmes se pare paraspitalore mjekesore dhe e emergjencave civile.
2. Edukimi, informimi dhe trajnimi I popullatës për mbrojtjen e parandalimin nga fatkeqësitë e ndryshme.
3. Organizimi I trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve të ndryshme në institucione shtetërore, shkolla, universitete me qëllim ndërgjegjësimin e popullatës mbi fatkeqësitë natyrore e ta të shkaktuara nga njeriu.
4. Të veprojë me devotshmëri e përkushtim për të ndihmuar popullatën në raste të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të shkaktuara nga dora e njerit, aksidentet rrugore dhe industrial, për shpëtimin e popullatës, gjesë së gjallë, pronës, mjedisit, infrastukturës kryesore.
5. Të ndihmoj cdo individ apo masat njerëzore ndaj një situatë urgjente ose emergjente që I paraqiten.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 1.Kohëzgjatja e “QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.)” do të jetë për një periudhë të papërcaktuar (pakufizuar) kohore.
- 2.Kjo do të përfundoj aktivitetin e saj me miratim në unanim të 3/5 te Bordit Drejtues dhe njerit prej Themeluesit të saj. Personi juridik do të përgatisë dokumentacionin për fillimin dhe përfundimin (mbylljen) e aktivitetit të Q.V.E.C.
3. Mandati I bordit drejtues ne kete organizate eshte 5-pese vjeçar me te drejte riperseritjeje dhe rikandidimi.

NENI 6 AKTIVITETI FINANCIAR

- 1.Me qëllim realizimin dhe mbështetjen e qëllimeve dhe objektivave të veprimtarisë të parashikuar në këtë Statut, “QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.)” ka një kapital prej.....lekë.
- A. Anëtarët e Bordit Drejtues kontribuojne financiarisht ne menyre të barabartë për detyrimet legjitime të mirëmbajtjes së QVEC pas nje votimi unanim konsensual.
- B. Këto të ardhura do të shërbejnë për aktivitetin, organizimin dhe ushtrimin e aktiviteteve dhe veprimtarive të ndryshme, të ligjshme te Q.V.E.C.
- C. Të ardhur e saj do të përfitohen nëpërmjet donacioneve, bashkëpunimit me partneret , marreveshjeve, kontratave të nënshkruara, sipas ofrimit të

shërbimeve të saj, kuotave të anëtarësimit, shitjet e aseteve të saj, apo cdo burim tjetër të përligjshëm.

2. Menyrat e të ardhurave dhe pasurimi I qendres do të jete nga:

- a) Donacione të ndryshme , të çfaredo natyre, të përligjshme.
- b) Të ardhura financiare si shperblim ndaj kontratave të shërbimeve të ofruara.
- c) Shitje të ndryshme që mund të bëjë Q.V.E.C.
- d) Projekte të ndryshme
- e) Bashkëpunimit ose marrëveshjeve me partnere
- e) Çdo burim tjetër i përligjshëm kontraktual

3. Burimet financiare do të shperndahen në mënyrë të tillë:

- a) për baze material dhe furnizimin e paisjeve të qendres,
- b) për trajnime dhe aktivitete,
- c) për projekte të ndryshme,
- d) për lobime, publicitet, promovim me qëllime positive ndaj rritjes dhe zhvillimit të Q.V.E.C. dhe faktorizimit të saj
- e) për pagesa rrogash dhe shperblime motivuese ndaj kontribueseve të organizatës tone,
- f) për të kryer donacione ndaj OJF-OJQ-ve që bashkepunojmë për të njëjtin qëllim ose individëve në nevojë.
- g) për të paguar ofrues shërbimesh të nenkontraktuar nga Q.V.E.C. për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e saj.

4. Vendimarrja e menaxhimit të fondeve dhe aseteve të Q.V.E.C. do të bëhet vetëm pas votimit të 3/5 e Anëtarëve të Bordit Drejtues .

NENI 7 STRUKTURA DREJTUESE

1. Struktura drejtuese e “QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.)” do të jetë:

a) Bordi Drejtues, i përbërë nga drejtori dhe zëvendësi I tij si dhe 3 anëtar, ku në tërësi përbëhet nga 5 anëtar.

b) Bordi Operacional (nga 3 deri në 23 anëtare)

c) Vullnetaret

3. Kompetencat e drejtorit dhe zëvendësit të tij janë të njëjta:

- A. Ushtron aktivitetin e tij konform ligjit duke ndjekur aktivitetin e “QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCAVE CIVILE (Q.V.E.C.)” dhe duke

- bërë të mundur ekzekutimin e programeve duke respektuar statusin dhe rregulloren e brendshme.
- B. Miraton aktivitetet, veprimtarinë, buxhetin dhe planet e përgatitura nga stafi I tij.
- C. Lidh kontratat, bashkëpunimet, binjakëzimet, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi Drejtues ose votimeve të kryera nga ky I fundit.
- D. Të mbajë në ruajtje aktet dhe dokumentacionin e Q.V.E.C.
- E. Të përfaqësoj "QENDRA VULLNETARE E EMERGJENCIVE CIVILE (Q.V.E.C.)" para autoriteteve qendrore e locale, institucioneve apo subjekteve private brenda dhe jashtë vendit. Në mungesë të tij, delegohet zëvendësi dhe në mungesë të tij delegohet një anëtar I bordit (me shkrim) për përfaqësimin e Q.V.E.C. sipas rregullave të përcaktuara.
- F. Prezanton Q.V.E.C. para organeve shtetërore, si: gjykatat, ministrinë, bankat, organet e qeverisjes qendrore e locale, ku përgatit të gjitha dokumentet konform ligjit, për tu paraqitur në organet e latpërmendura.
- G. Kur drejtori ka mosperputhje ndaj një ceshtje ose veprimi ose vendimi atëhere kjo gjë hidhet në votim të bordit drejtues.
- H. Kane të drejtën të bëjnë propozime të ndryshme drejt bordit drejtues (brenda dhe jashtë rendit të dës) dhe vendimi që merri bordi pas votimit është ekzekutiv.
- I. Kane të drejtë të leshojnë urdhra ose vendime të perkohshme për raste urgjente (me vlefshmeri jo më shumë se 20 ditë pune dhe ku pasojat ekonomike nuk tejkalojnë 1.000 euro). Në këto raste justifikimet dhe argumentimet e urdhrave apo vendimeve duhet të marrin sa më parë miratimin e bordit me shumicë të thjeshtë 3/5; nëse bordi nuk e voton atëhere pasojat ekonomike I mbyllon personalisht urdheruesi.
- J. Drejtori I bordit drejtues mund të japë dorëheqje në çdo moment nga ky pozicion dhe të mbetet anëtar bordi drejtues dhe pozicioni I tij rizgjidhet me votim nga njëri prej anëtarëve të bordit drejtues ekzistues të mandatuar.
- 4.a.Vullnetaret aktiv votojnë anëtarë të Bordit Operacional dhe këta propozojnë anëtarët e Bordit drejtues, pas një votimi të brendshëm të bordit drejtues perzgjidhet drejtori I qendrës dhe automatikisht I dyti në votë është zv.drejtori.
- b.Kriteret e perzgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtues:
- Të jetë me historik kontribues të gjatë në QVEC
 - Të jetë bashkëpunues dhe të mos rrendoj ndaj tij ndonjë proces penal.

-Te kete certifikime te shumta ne fushen e mergjencave civile dhe sektoreve te tij.

-Te kete pelqimin e te pakten dy themelueseve te pare te QVEC.

Nese keto kritere nuk plotesohen, nuk do mund te propozohen per anetare te bordit drejtues.

5.Ne mungese te strukturimit numerik per tu kryer keto procese zgjedhore, vullnetaret me te vjeter me kontribut historic te qendres mund te vetshpallen/vetzgjidhen dhe mbajne te hapur QVEC.

6.a.Nese nje anetar I bordit drejtues apo atit operacional jep doreheqen gjate mandatit 5 vjecar, pozicioni I tij zevendesohet me kooptim dhe votim nga anetaret e mbetur te bordit drejtues.

b.Bordi drejtues fillestar I mandatuar mund te shtoj gjate mandatit te tij anetare te rinj ne bordin drejtues nepermjet votimit te brendshem.

7.Cdo dokumentim shkresor fizik, incizim audiovizual apo zanor ,me cdo lloj mjeti komunikimi te perligjshem (post, email, cellular, fax), ka vlere juridike per QVEC ne kuptimin e votimit apo urdherimit apo pergjigjes zyrtare brenda strukturave te qendres dhe institucioneve apo partnereve bashkepunues me QVEC.

NENI 8 ANËTARËT E BORDIT DREJTUES

1. Bordi Drejtues është organi vendimmarrës.
2. Anetaret e bordit mund te shtohen pas votimit me unanimitet te plote 5/5 te anetareve te bordit ekzistues. Ata vendosin për cdo cështje që paraqitet nga bordi operacional.
3. Mbledhja e Bordit Drejtues bëhet minimalisht tre (3) herë në vit.
4. Cdo akt rregullativ, marreveshje, bashkepunim, projekt, document, politike e QVEC mer implementim vetem pas votimit dhe miratimit nga ky bord.
5. Cdo anetar bordi mund te japi doreheqe me shkrim ne çdo moment gjate mandatit pesevjecar dhe zevendesimi I tij behet me kooptim nga nje propozim I drejtuesit te qendres dhe miratimin e propozimit nga anetaresia ekzistuese.
6. Bordi drejtues nuk mban pergjegjesi ndaj veprimeve apo mosveprimeve te vullnetareve te kesaj qendre qe mund te japin pasoja ligjore, pasi pergjegjesia eshte individuale.
7. Anetari i bordit drejtues eshte me pare vullnetar aktiv.

8. Anëtarët e Bordit Drejtues për mandatin 2024-2029 janë, :12345

NENI 9 ANËTARËT E BORDIT OPERACIONAL

1. Bordi operacional përbëhet prej jo me pak se 3 dhe jo më shumë se 23 persona. Ai propozohet nga vullnetaret aktive të Q.V.E.C. dhe zgjidhet nga Bordi Drejtues .
2. Kopetencat e anetarit të bordit operacional:
 - A. -Ushtron aktivitetin e tij konform ligjit duke ndjekur aktivitetin e Q.V.E.C. dhe duke bërë të mundur ekzekutimin e urdhrave, direktivave, duke respektuar statusin dhe rregulloren e brendshme, dokumentat zyrtare të QVEC, si dhe akte të tjera rregullative që burojnë nga ky institucion.
 - B. -Të mbajë në ruajtje aktet dhe dokumentacionin e Q.V.E.C., bazen materiale dhe asetet e qendres.
 - C. -Të përfaqësojë Q.V.E.C. para autoriteteve që i kërkojnë ose i urdherohen eventualisht.
 - D. -Sipas funksionit specifik që ka cdo antar i bordit operacional, mban dhe përgjegjësinë individuale.
 - E. Antari i bordit operacional me detyrë kordinator projekti, ka për mision ndjekjen e një projekti të caktuar, ka përgjegjësi personale ligjore për intereset e projektit. Për rrjedhojë ai vendos vetën ndaj shkelesave nëse nuk plotësohen kushtet ligjore shtetërore apo pikat e kontratës së dakortësuar.
 - F. Anëtar i bordit operacional mund të marrë pozicion drejtues ose kordinues ndaj një nga 4 shërbimet e QVEC, apo të ndonjë sektori dhe nënsektori të saj.
 - G. Anetari i bordit operacional nuk mund të jetë anetar i ndonjë OJF/OJQ tjetër me qëllime apo misione të përngjashme me ato të QVEC.
 - H. Anetari i bordit operacional është me parë vullnetar aktiv.

NENI 10 VULLNETARI

- 1.Cdo shtetas i perligjur në republikën e shqiperisë mund të aderoj brenda qendres tona për të kontribuar vullnetarisht ndaj komunitetit ku ne shërbejmë.
- 2.Vullnetari në momentin kur aplikon për të QVEC nuk duhet të jetë në kërkim nga organet e rendit dhe as të ketë ndonjë semundje që mund të përbejë rrezik për të gjatë aktivitetin në QVEC apo komunitetit ose individit që u shërben.

3.Cdo individ qe deshiron ta aderoj te QVEC per te sherbyer, ka marre persiper te gjitha rrisqet dhe rreziqet qe buron nga ky akt dhe nuk ka asnje pretendim ndaj QVEC.

4.Per cdo veprim apo mosveprim me pasoja negative morale apo ligjore te nje vullnetari ndaj komunitetit apo individit qe I sherben, pergjegjesia eshte individuale.

5.QVEC nuk ka asnje detyrim per shperblim financiar, material apo cfaredo lloj forme tjeter dhe natyre ndaj cdo lloj vullnetari, pasi secili vjen me iniciative personale me vetmohim per tu solidarizuar ndaj nje kauze apo situate emergjente qe ai e mendon dhe e vlereson te aresyeshme (nen liri dhe vullnet te plote) per te kontribuar. Per rrjedhoj cdo vullnetar, pranon se nuk ka asnje pretendim ndaj QVEC.

6.Vullnetaret jane spontan (qe paraqiten eventualisht me koh te pjeseshme ose per nje here te vetme per nje situate te caktuar emergjente dhe kerkojne ti sherbejne komunitetit ne nevojte nen uniformen dhe logon tone) ose aktivi te rregullt qe kane eksperience dhe trajnime te ndryshme sipas fushes se veprimit profesional apo specialitetit perkates. Cdo vullnetare qe do aderoj ne QVEC, do duhet te plotesoj dokumentacionin perkates (formulari kerkeses se aderimit dhe deklaraten e vullnetarit)

7.Vullnetari Spontan:

- A. Ben kerkesen me shkrim per tu aderuar ne QVEC dhe duke plotesuar deklaraten perkatese.
- B. Veprimtaria e tij eshte e pa percaktuar ne kohe dhe pa asnje detyrim ndaj QVEC apo kjo e fundit ndaj tij.
- C. Ky vullnetar ofron sherbimin sipas arsimit apo trajnimit qe mund te kete pasur me pare.
- D. Veprimtaria e tij eshte e kufizuar sipas profilit arsimor dhe kapacitetetve fiziko-biologjike qe mund te kete.
- E. Ka vetem rol ndihmes.
- F. Nuk ka detyrime per kuota anetaresimi vjetore dhe nuk mund te marre pagesa motivuese mirenjohjeje apo te punesohet gjate nje projekti apo nenkontraktimi te QVEC me institucionet bashkepunetore te saj.
- G. Nuk e ka gjithmon te drejten e perzgjedhjes se sherbimit ku deshiron te kontriboj.
- H. Nuk ka te drejte te zgjedh e te zgjidhet si dhe te propozoje per zgjedhje brenda hierarkise dhe instancave te QVEC.
- I. Ka te drejte te angazhohet dhe te propozoj projekte per QVEC.

8. Vullnetari Aktiv :

- A. Ben kerkesen me shkrim per tu anetaresuar ne QVEC dhe duke plotesuar deklaraten perkatese.
- B. Veprimtaria e tij eshte e percaktuar ne kohe dhe me detyra ndaj QVEC dhe kjo e fundit ndaj tij te cilat percaktohen me akte rregullative.
- C. Ky vullnetar ofron sherbimin sipas arsimit apo trajnimit qe mund te kete pasur me pare por dhe trajnimeve te avancuara nga QVEC.
- D. Veprimtaria e tij eshte e moderuar deri ne e pakufizuar sipas profilit arsimor, trajnimeve te kryera dhe kapacitetetve fiziko-biologjike qe mund te kete.
- E. Ka rol ndihmes dhe operativ.
- F. Kane detyrime per kuota anetaresimi vjetore dhe mund te marre pagesa motivuese mirenjohjeje apo te punesohet gjate nje projekti apo nenkontraktimi te QVEC me institucionet bashkepunetore te saj .
- G. Gezon te gjitha te drejtat legjitime qe burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore te miratuara nga parlamenti dhe institucionet e Republikes se Shqiperise.
- H. Ka te drejten e perzgjedhjes se sherbimit ku deshiron te kontriboj.
- I. Ka te drejte te zgjedh e te zgjidhet si dhe te propozoje per zgjedhje brenda hierarkise dhe instancave te QVEC.
- J. Ka te drejte te angazhohet dhe te propozoj projekte per QVEC.
- K. Eshte I rankuar me grada dhe simbole te QVEC.

9.Cdo demtim, fizik (material) ose moral, qe nje Vullnetar I ben QVEC do duhet ta kompesoje duke e zevendesuar me nje tjeter ose duke e blere te re ose duke iu nenshtruar procedurave ligjore per demshperblim sipas rregullores se QVEC dhe ligjeve ne fuqi.

10.Vullnetari spontan dhe aktiv, mund te pezullohet me vendimin e drejtorit dhe te perjashtohet me vendim bordit drejtues nese kryhen veprime apo mosveprime qe demtojne QVEC.

NENI 11 EKSPERTI KONTABEL

Eksperti kontabël zgjidhet nga Bordi Drejtues dhe është përgjegjës për ceshtjet ekonomike dhe financiare të Q.V.E.C., administrimin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai ndjek aktivitetin financiar kontrollon dhe monitoron procedurat financiare të Q.V.E.C.

Ekspteri qendron në detyrë I emëruar sipas kontratës së përgatitur dhe nënshkruar. Ai informon bordin drejtues në mënyrë të vazhdueshme dhe paraqet një raport cdo 3,6 ose 12 muaj mbi aktivitetin financiar dhe detyrimet e qendres ndaj shtetit apo institucioneve të tjera (publike ose jo) që bashkepunojnë me QVEC.

NENI 12 BASHKIMI DHE SHPËRNDARJA E Q.V.E.C.

Q.V.E.C. mund të transferohet apo bashkohet me ndonjë OJQ tjetër për qëllime apo synime të njëjta. shpërndahet kur: Nuk ka realizuar qëllimin dhe synimet e saj, si dhe nëse vendoset shpërndarja vullnetarisht.

NENI 13 DOKUMENTACIONI, LIBRAT DHE RREGJISTRAT

Q.V.E.C. ruan dokumentacionin e saj, ku përfshin: libra financiare, shpenzime, proces verbale, plane apo akte bashkëpunimi, librin e veprimtarive, lista e personave pjesëmarrës me adresë të sakta dhe identitetin e tyre, si dhe pozicionet e gjithsecilit SI DHE CDO AKT OSE DOKUMENT TJETER QE BURON OSE KA LIDHJE ME Q.V.E.C.

Pas themelimit në gjykatë, Brenda këtij mandati, duhet të paraqitet statute perfundimtar, rregullorja e brendshme, rregullorja e vullnetareve si dhe protokollet e veprimeve sipas sektoreve.

NENI 14 TAKSAT DHE DETYRIMET FISKALE

Në përputhje me Nenin 41 të ligjit 8788 datë 7.5.2001, organizatat jofitimpruese janë të përjashtuara apo lehtësohen nga taksat apo detyrimet e tjera fiskale. Q.V.E.C. është e përjashtuar gjithashtu edhe nga tatimi mbi të ardhurat e realizuara apo dhurimet nga cdo burim i ligjshëm.

NENI 15 VULA

Q.V.E.C. ka vulën e saj, të cilët do ta përdorë në cdo dokumentacion të leshuar nga drejtuesi i saj. Me shpërnadrjen e aktivitetit kjo vulë asgjësohet me proces verbal të përbashkët në përbërje të përfaqësuesve ligjorë.

NENI 16 Dispozita specifike të Q.V.E.C.

1. Kjo qender ka uniformën e saj operacionale universale me ngjyrë të kuqe dhe shiritë të bardha ose të verdha fosforizuese me vizualitet të lartë (pantallonat, bluzat me mëngje të gjata ose të shkurtra, bluzat).

2. Ne pjesen e kurizit dhene pjesen e perparme majtas ka logon e qendres, opsionale per vullnetaret aktiv eshte vendosja e grades, sektorit, flamurin kombetar etj sipas rregullores perkatese.

3. Logoja e QVEC eshte:



4. Logot, gradimi dhe simbolet e tjera te uniformes operative te punes (sipas sektoreve) dhe uniformes zyrtare, percaktohen ne rregulloren e brendeshme.

5. Askush nuk mund te perdure logon e qendres ne mjete pa autorizim perkates me shkrim nga drejtuesi I qendres.

6. Cdo veprim, cdo levizje e mjeteve dhe aseteve te QVEC behet vetem pas nje miratimi te bordit drejtues dhe akteve te tjera rregullative.

7. Cdo mjet, send apo asset qe I dhurohet QVEC inventarizohet si prone e sajje legjitime dhe veprimtaria me to miratohet nga bordi drejtues.

8. Struktura, sektoret dhe nensektoret e QVEC paraqitet ne tabelen e meposhtme,:

Δ* Shërbimi Shëndetësor A	Δ* Shërbimi Emergjencave Civile B	Δ* Shërbimi Social C
☐ Sektori i ndihmës së parë	☐ Sektori Zjarrfikësës ☐ Urban/ ☐ Pyje	☐ Sektori mbështetjes psikologjike
☐ Sektori urgjencës paraspitalore	☐ Sektori Emergjencave Civile	☐ Sektori i menaxhimit të kampeve
☐ Mjek	☐ Inxhinjer	☐ Lavanderi
☐ Informimet	☐ Sizmolog	☐ Guzhina
☐ Paramedic	☐ Meteorolog	☐ Siguria
☐ Personel Mjekësor Ndihmës	☐ Specialist/projekte	☐ Hidraulik
	☐ Siguria ☐ Teknik	☐ Elektricitet
		☐ Mirembajtje
☐ Sektori Mjekësor	☐ Sektori Kërkim Shpëtimit	☐ Sektori Juridik
☐ Përgjithshme	☐ Tokësor	☐ Sektori Ekonomiko-financiar
☐ Spitali Ekuhor	☐ Malor	☐ Sektori Social - Kulturor
☐ Mjek Specialist	☐ Minjera/Shpella	☐ Sektori rinisë & moshës së tretë
☐ Mjekësi e katastrofave	☐ Ujor	
☐ Mjekësi pa kufi	☐ Detar	
	☐ Liçen	
	☐ Pishina	
	☐ Lum	
	☐ Ajror	
	☐ Kafsheve	
	☐ Qen	
	☐ Mbjetesa	
	☐ Sektori Natyres/Ambientalist	☐ Sektori i sporteve
☐ SHERBIMI UNIVERSAL ABC Sektoret:Ndihma e parë, Kërkim Shpëtimit, Zjarrfikës dhe sektori i kampeve		

-Sqarim: te shërbimi social, bën pjesë edhe sektori i mbrojtjes ambientale.

NENI 17 DISPOZITA Të PËRGJITHËSHME

Ky statut hyn në fuqi me rregjistrimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës të Q.V.E.C., si dhe po këtë ditë njihet edhe si person juridik.

Ky status përbëhet nga 12 faqe dhe u hartua në tre kopje në gjuhën shqipe, me fuqi të barabarta ligjore.

1. Z.Grej MALO, Grej Malo Malo
2. Z.Nebi MUCAJ, Nebi Mucay
3. Z.Julian BENDO, Julian Bendo
4. Znj.Miranda PRIFTI, Miranda Prifti
5. Z.Gentian HOXHOLLI, Gentian Hoallu